



DRAFT FILLESTAR

RREGULLORE Nr. XXXXX PËR TAKSËN E AKOMODIMIT NË KOMUNËN E PEJËS

Bazuar në dispozitat e nenit 42 dhe 43 të Ligjit Nr. 08/L-074 për Turizmin, Nenit 8, Pika i) të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal dhe Nenit 12, Paragrafit 12.2, pika c) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Kuvendi i Komunës së Pejës, në mbledhjen e mbajtur me date, xxxx, nxjerrë këtë:

RREGULLORE Nr. XXXXX PËR TAKSËN E AKOMODIMIT NË KOMUNËN E PEJËS

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim vendosjen, përlllogaritjen, mbledhjen dhe përcaktimin e qëllimeve të destinimit të taksës së akomodimit për Komunën e Pejës, duke synuar zhvillimin dhe promovimin e turizmit në komunën Pejës.

Neni 2 Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen për të gjitha subjektet që ofrojnë shërbime akomodimi brenda territorit të Komunës së Pejës, klientët e strukturave akomoduese, dhe për drejtoritë përkatëse të Komunës Pejës të cilat kanë detyrime sipas kësaj rregulloreje apo akteve tjera për planifikimin dhe mbledhjen e të hyrave nga taksa e akomodimit.

Neni 3 Përkufizimet

1. Për qëllimet e kësaj rregulloreje, termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

1.1 **Taksa e akomodimit** – Taksa e akomodimit është taks që paguan klienti i strukturës akomoduese që përlllogaritet dhe paguhet për çdo natë qëndrim në një strukturë akomoduese, e cila administrohet nga subjektet e akomodimit dhe trajtohet si e hyrë vetanake e Komunës së Pejës, e destinuar për promovimin dhe zhvillimin e turizmit.

1.2 **Të hyra të dedikuara** – Të hyrat e mbledhura nga taka e akomodimit i destinohen ekskluzivisht për zhvillimin dhe promovimin e turizmit siç përcaktohet në këtë rregullore.

1.3 **Struktura akomoduese**, për qëllime të kësaj rregulloreje përfshinë: Hotel, Motel, hostel, resort, fshat turistik, bujtinë (shtëpi pritëse), kamping, qendër kurative, fjetje dhe mëngjes (B&B) apo struktura të tjera që ofrojnë shërbime akomodimi, duke përfshirë apartamentet të cilat ofrojnë akomodim afatshkurtër për turistët.

1.4. **Njësi akomodimi** - dhomë, apartament, shtëpi e pushimit, tendat e kampingut ose ndonjë objekt tjetër që përdoret për të siguruar strehim për mysafirët dhe që përputhet me kushtet minimale teknike të rregulluara me ligjin e turizmit, dhe këtë rregullore, përfshirë:

1.5. **Hotel** - një objekt biznesi që kryen veprimtari mikpritëse me qëllim të ofrimit të shërbimeve të akomodimit, përgatitjes dhe shërbimit të ushqimit dhe pijeve, me një pritje, lobi, restorant me një kuzhinë dhe njësi akomodimi;

1.6. **Motel** - ndërtesë që ofron shërbim akomodimi dhe parkimi, zakonisht me synimin për qëndrim të shkurtër të udhëtarëve, me vendndodhje në periferi të qendrave të banuara, pranë kryqëzimeve dhe rrugëve automobilistike;

1.7. **Hostel** - ndërtesë që ofron akomodim dhe ushqim me çmime ekonomike, zakonisht për udhëtarë, studentë dhe punëtorë, ku dhoma ndahet mes disa klientëve të ndryshëm;

1.8. **Resort** - kompleks i ndërtesave për pushim dhe argëtim, të grupuara e të administruara së bashku, si: hotele, apartamente, villa, studio, që u ofron klientëve akomodim, ushqim, pije, veprimtari sportive e argëtuese dhe shërbime ndihmëse;

1.9. **Fshat turistik** - strukturë e organizuar në formë fshati, me përqendrim të burimeve turistike, të klasifikuar në përputhje me standardet e miratuara për zhvillimin e turizmit;

1.10. **Bujtinë (shtëpi pritëse)** - ndërtesë një pjesë e së cilës përdoret si rezidencë e pronarit dhe ku ofrohet akomodim dhe ushqim për turistët;

1.11. **Kamping** - zonë publike ose private të pajisur me infrastrukturë të domosdoshme (ujë, tualete, energji elektrike etj.), ku udhëtarët mund të akomodohen në tendat e kampingut, apo të ngrenë tendat e tyre ose të parkojnë mjetin motorik akomodues (kampshtëpizë);

1.12. **Qendër kurative** - strukturë akomoduese me vendndodhje në zona me potenciale shëruese natyrore, të cilat stimulohen nga toka, uji, rëra e klima dhe që shërbejnë për kryerjen e terapive shëruese;

1.13. **Fjetje dhe mëngjes (B&B)** - strukturë akomoduese që ofron shërbimin e fjetjes dhe mëngjesit brenda çmimit të dhomës.

2. Termat dhe Përkufizimet e tjera të përdorura në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim siç janë përcaktuar në Ligjin përkatës për Turizmin, Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal, Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike.

II. TAKSA E AKOMODIMIT DHE LARTËSIA E SAJ

Neni 4

Lartësia e Taksa së Akomodimit dhe përlogaritja e saj

1. Taksa e akomodimit aplikohet si përqindje e çmimit të përgjithshëm të njësisë së akomodimit për një natë qëndrimi, e përcaktuar si një për qind (1%) të çmimit të përgjithshëm të akomodimit.
2. Çmimi i përgjithshëm i akomodimit do të konsiderohet çmimi neto (para se të llogaritet TVSH) për shërbimin e akomodimit, mbi bazën e të cilit do të llogaritet taksa e akomodimit.
3. Me rastin e kalkulimit të taksës së akomodimit, si bazë për përlogaritjen e taksës së akomodimit merret vetëm çmimi i akomodimit dhe nuk përfshihen shërbimet shtesë.
4. Taksa e akomodimit do të faturohet për njësi akomodimi për natë qëndrimi, pavarësisht numrit të personave që qëndrojnë në njësi akomodimi, duke marrë për bazë faktin se çmimi i njësisë për njësi reflekton numrin e mysafirëve për atë njësi akomodimi në strukturën përkatëse akomoduese.
5. Taksa e akomodimit nuk është e aplikueshme, për rastet kur struktura shfrytëzohet me synimin për qëndrim të shkurtër të udhëtarëve dhe që nuk bie brenda përkufizimit për natë qëndrimi

Neni 5

Përfshirjet nga taksa e akomodimit

1. Nga pagesa e taksës së akomodimit përjashtohen kategoritë si në vijim:
 - 1.1. fëmijët nën moshën shtatë (7) vjeç;
 - 1.2. personat me referim mjekësor që qëndrojnë në natyrë me qëllim të shërimit;
 - 1.3. personat e siguruar për të cilët, sipas paraqitjes së fotokopjes së një vendimi të autoritetit kompetent, është e qartë se kanë aftësi të kufizuar ose dëmtim fizik, ose në bazë të një kartejele anëtarësimi të një organizate të aftësisë së kufizuar;
 - 1.4. nxënësit, studentët, udhëheqësit ose mentorët e tyre, pjesëmarrësit në programet edukative të organizuara nga shoqëritë dhe institucionet e tjera arsimore në baza jofitimprurëse ose nga komunitetet fetare dhe të tjera si pjesë e aktiviteteve të tyre të rregullta;
 - 1.5. nxënësit në konviktet e shkollave dhe konviktet e studentëve;
 - 1.6. personat të cilët punojnë përkohësisht dhe jetojnë në një objekt të industrisë ushqimore për më shumë se tridhjetë (30) ditë;
 - 1.7. shtetasit e huaj të cilët janë të liruar nga taksa e akomodimit në përputhje me rregulloret dhe marrëveshjet ndërkombëtare;

1.8. anëtarët e shoqatave të cilët merren me aktivitete sportive, në bazë të një karte të vlefshme të anëtarësimit në një shoqatë sporti

2. Subjekti që ushtron veprimtarinë në strukturën akomoduese ka për detyrë të mbajë shënime për çdo person që është liruar nga taksa e akomodimit sipas këtij neni, dhe të ofroj këto informata në rast inspektimi nga Komuna.

Neni 6 Zbatimi i Përrjashtimeve

1. Nëse në një njësi të strukturës akomoduese qëndrojnë vetëm persona të përjashtuar sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje, taksa e akomodimit nuk aplikohet.

2. Nëse në një njësi akomodimi qëndrojnë persona të përjashtuar edhe persona ndaj të cilëve aplikohet taksa e akomodimit, taksa aplikohet e plotë për atë njësi të strukturës akomoduese.

3. Ofruesit e shërbimit të akomodimit duhet të verifikojnë dhe të ruajnë dokumentacionin mbështetës gjatë regjistrimit të mysafirëve për rastet kur aplikojnë përjashtimet nga taksa e akomodimit si në nenin 5 të kësaj rregulloreje.

Neni 7 Detyrimi për Mbledhjen dhe pagesën e Taksa së Akomodimit

1. Taksa e akomodimit është taks që paguan klienti/mysafiri i strukturës akomoduese.

2. Taksa e akomodimit mbledhet nga ofruesi i shërbimit të akomodimit në momentin e pagesës nga mysafiri dhe duhet të figurojë veçmas në faturë.

3. Ofruesit e akomodimit duhet të transferojnë taksën e mbledhur në llogarinë e komunës sipas procedurave të pagesës të përcaktuara nga komuna e Pejës në baza mujore, më së largu deri më datën 15 të çdo muaji, për muajin paraprak.

4. Ofruesit e shërbimeve të akomodimit, kryejnë pagesën përmes dëftesës e cila u ofrohet në mënyrë elektronike nga Komuna e Pejës, në të cilën është specifikuar UNIREF që është i ndërlidhur me taksën e akomodimit.

III. PLANIFIKIMI DHE SHPENZIMI I TË HYRAVE NGA TAKSA E AKOMODIMIT

Neni 8 Planifikimi dhe mbledhja e të hyrave nga taksa e akomodimit

1. Planifikimi i të hyrave bëhet duke u bazuar në kërkesat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal dhe akteve nënligjore të nxjerra nga Ministria përgjegjëse për Financa.

2. Taksa e akomodimit si kategori e të hyrave vetanake të komunës përcaktohet në kuadër të planit kontabël të Thesarit dhe planit kontabël të komunës.

3. Për taksën e akomodimit, lëshohet një UNIREF i veçantë me anë të cilit do të mundësohet pagesa dhe destinimi i të hyrave nga taksa e akomodimit në procesin e buxhetimit.

Neni 9

Destinimi i të hyrave nga taksa e akomodimit në Komunën e Pejës

1. Të hyrat nga taksa e akomodimit janë të hyra vetanake të Komunës së Pejës dhe i dedikohen ekskluzivisht promovimin dhe zhvillimin e turizmit, si në vijim:

1.1 Zhvillimin e infrastrukturës turistike, përfshirë:

1.1.1 Përmirësimin dhe mirëmbajtjen e shtigjeve malore, parqeve natyrore dhe pikave turistike;

1.1.2 Krijimin ose përmirësimin e qendrave informative për vizitorët;

1.1.3 Zhvillimin e sinjalistikës turistike dhe vendosjen e tabelave informuese;

1.1.4 Mbështetjen e projekteve të qëndrueshme për turizmin ekologjik dhe rural;

1.1.5 Projekte tjera të infrastrukturës turistike të cilat mbi bazën e konsultimit me akterët në fushën e turizmit konsiderohen të rëndësishme për turizmin në Komunën e Pejës.

1.1.6 Mbështetjen e investimeve në aktivitete të ndryshme turistike (zhvillimin e produkteve turistike).

1.2 Promovimin e ofertës turistike të Komunës së Pejës, përfshirë:

1.2.1 Krijimin dhe shpërndarjen e materialeve promovuese (broshura, video, platforma dixhitale);

1.2.2 Organizimin e fushatave të marketingut për tërheqjen e vizitorëve;

1.2.3 Pjesëmarrjen dhe prezantimin në panaire vendore dhe ndërkombëtare të turizmit;

1.2.4 Mbështetjen e iniciativave për certifikimin dhe standardizimin e shërbimeve turistike;

1.3 Organizimin e aktiviteteve dhe ngjarjeve që nxisin turizmin, përfshirë:

1.3.1 Festivale kulturore dhe artistike me rëndësi për turizmin;

1.3.2 Gara sportive dhe aktivitete rekreative që promovojnë turizmin aktiv;

1.3.3 Konferenca dhe forume për zhvillimin e turizmit dhe inovacionin në këtë sektor;

1.3.4 Projekte edukative dhe trajnime për ofruesit e shërbimeve turistike.

1.4 zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm:

1.4.1 Përmirësimin e infrastrukturës turistike të qëndrueshme (p.sh. ndriçimi ekologjik, menaxhimi i mbeturinave).

1.4.2 Mbështetjen e bizneseve turistike në praktika të qëndrueshme (p.sh. energjia e ripërtërishme, certifikimet e qëndrueshmërisë).

1.4.3 Diversifikimin e ofertës turistike për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike (p.sh. aktivitete alternative në mungesë bore).

2. Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve bëhet përmes procesit të rregullt të buxhetor, duke siguruar transparencë dhe përputhje me prioritetet strategjike të zhvillimit të turizmit në Komunën e Pejës.

Neni 10

Konsultimi me akterët në fushën e turizmit gjatë procesit të buxhetimit

1. Në procesin e miratimit të propozim-buxhetit, Drejtoria përgjegjëse për turizmin dhe Drejtoria përgjegjëse për Financa konsultohet me akterët e sektorit të turizmit për të planifikuar projektet përkatëse që financohen përmes taksës së akomodimit. Ky konsultim përfshin shoqatat e turizmit, shoqatat e hotelierisë, shoqërinë civile dhe subjektet e tjera që operojnë në fushën e turizmit.

2. Konsultimet organizohen nga Drejtoria përgjegjëse për Turizmin dhe Drejtoria përgjegjëse për Financa, me qëllim të garantimit të transparencës dhe përputhjes së shpenzimeve me interesat e sektorit të turizmit gjatë procesit të buxhetimit.

3. Procesi konsultues i zhvilluar në përputhje me rregulloret për gjithashtu duhet të ketë një rol promovues për rëndësinë dhe përfitimet e taksës së akomodimit, duke rritur ndërgjegjësimin dhe bashkëpunimin mes institucioneve dhe akterëve të turizmit.

IV. TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA

Neni 11

Raportimi dhe Monitorimi

Komuna e Pejës, publikon në faqen e saj të internetit në baza tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore raportin mbi mbledhjen dhe shpenzimin e të hyrave nga taksa e akomodimit.

Neni 12

Mbajtja e shënimeve

1. Çdo subjekt afarist që ushtron veprimtarinë e akomodimit, konform dispozitave të ligjit për turizmin, është i obliguar të mbaj shënimet përkitazi me netët e qëndrimit, shumën e paguar për natë qëndrimi.

2. Në të dhënat e tilla mund të kërkohet qasje për qëllime inspektimi, dhe duke vepruar në përputhje me legjislacionin për Mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Për çdo klient që ka shfrytëzuar strukturën akomoduese, dhe i cili është i liruar sipas ndonjë baze të përcaktuar në Ligjin e Turizmit dhe këtë rregullore, struktura akomoduese duhet të mbaj shënime përkatëse për bazën e lirit.

4. Kërkesat e këtij neni, kanë të bëjnë ekskluzivisht me aplikimin e taksës së akomodimit dhe nuk kufizojnë apo nuk ndërhyjnë në kërkesat e parapara me legjislacionin tjetër që ndërlidhet me strukturat akomoduese.

Neni 13

E Drejta për Inspektim dhe Verifikim

1. Komuna e Pejës, përmes inspeksionit komunal të tregut ka të drejtë të kryejë inspektime dhe të verifikojë pagesën e taksës së akomodimit nga çdo strukturë akomoduese në territorin komunës së Pejës.

2. Inspektorët komunalë mund të kërkojnë qasje në dokumentacionin financiar që lidhet me pagesat e taksës, duke përfshirë fatura dhe regjistrime të klientëve, pa cenuar të drejtën e privatësisë dhe të dhënat personale konform kërkesave të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Strukturat akomoduese janë të detyruara të bashkëpunojnë me inspektorët dhe të ofrojnë dokumentet e kërkuara brenda afateve të kërkuara.

4. Për mos përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në këtë rregullore mund të shqiptohen gjoba sipas legjislacionit përkatës për Kundërvajtje.

V. GJOBAT PËR MOSMBLEDHJEN E TAKSËS SË AKOMODIMIT

Neni 14

Gjobat në rast të mosmbledhjes dhe mos pagesës me kohë të taksës së akomodimit

1. Për mos mbledhjen e taksës së akomodimit, apo mos pagesën me kohë në llogarinë e komunës shqiptohen gjobat në vijim:

1.1 Ndaj subjektit që ushtron veprimtarinë e strukturës akomoduese, shqiptohet gjoba në lartësinë prej 1000 Euro.

1.2 Ndaj personit përgjegjës të personit juridik shqiptohet gjoba në lartësinë prej 500 Euro.

2. Pagesa e gjobave bëhet në përputhje me kërkesat e ligjit përkatës për kundërvajtje, ndërsa ët hyrat nga këto gjoba janë të hyra vetanake të komunës së Pejës.

VI.DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 15 Hyrja në Fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi më 1 Janar të vitit 2026.

Pejë, xx.xx. 2025

Nënshkrimi
Emri Mbimri, Pozita